

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE JURIST

Pozicioni: Jurist

Tipologjia: Me kohë të plotë

Data e fillimit: 15/10/2024

Afati i aplikimit: 7/10/2024

Rreth UMT

Universiteti Metropolitan Tirana është universitet i çertifikuar nga MAS i përbërë nga tre fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT.

I klasifikuar si një nga universitetet më të mirë në Shqipëri, një rëndësi e veçantë i është dhënë kohët e fundit krijimit të një ekosistemi ndërmarrjesh, inovacionit pedagogjik si dhe strukturimit të aktiviteteve shkencore rreth shkollave të doktoraturës në bashkëpunim me institucione dhe kolegë nga Evropa dhe SHBA.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Ofron këshilla ligjore për drejtuesit e universitetit dhe departamentet e ndryshme.
- Siguron interpretimin e saktë të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme për universitetin.
- Përgatit dhe shqyrton kontrata, marrëveshje, politika dhe dokumente të tjera ligjore.
- Siguron që të gjitha dokumentet të jenë në përputhje me ligjin dhe rregulloret e brendshme të universitetit.
- Drejton dhe përgatit proceset që lidhen me MAS dhe QSHA sipas legjislacionit(aplikim për kuota, aplikim për miratim kapacitetesh të reja, aplikim për liçensim kursesh, njoftim kriteresh në QSHA dhe kërkesa të tjera të këtyre institucioneve sipas shkresave përkatëse)
- Përgatitja dhe dorëzimi i dokumentacionit ligjor për aplikim për akreditim të programeve të reja në organet kompetente në bashkëpunim me departamentet përkatëse.
- Monitorimi dhe informimi i stafit akademik dhe administrativ për ndryshimet dhe përmirësimet ligjore në lidhje me akreditimin e programeve.
- Monitoron ndryshimet në legjislacionin e arsimit dhe siguron që universiteti të jetë në përputhje me këto ndryshime.
- Informon rregullisht drejtuesit e universitetit për ndryshimet ligjore që mund të ndikojnë në politikat dhe procedurat e pranimit të studentëve.
- Bashkëpunon me departamentin e burimeve njerëzore për të siguruar që të gjitha procedurat e rekrutimit të stafit të huaj të jenë në përputhje me ligjin.
- Siguron që kontratat dhe marrëveshjet e punës të jenë të përputhshme me kërkesat ligjore të vendit të origjinës së stafit dhe të vendit pritës.

- Kryen procedurat e aplikimit për vize pune leje pune e qëndrimi, sipas legjislacionit në fuqi.

Kualifikimet dhe eksperiencia

Universiteti Metropolitan Tirana po kërkon të rekrutojë **Jurist**.

Juristi është përgjegjës për sigurimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së universitetit me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme si edhe këshillim ligjor për institucionin.

Kualifikimet dhe Kërkesat:

- Diplomë e avancuar në Drejtësi
- Përvojë të paktën 5 vjeçare në një pozicion të ngjashëm, preferohet përvojë në sektorin e arsimit të lartë.
- Njohuri të thelluara të ligjit të arsimit, VKM, Kodit të Punës, Sigurimit të Cilësisë, ligjit për studentët dhe lektorët ndërkombëtarë, ligjit për arkivat, institucionet dhe palët e treta të lidhura me universitetin.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe analitike
- Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe pune në ekip.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

Aplikimi

Kandidatët duhet të dërgojnë në format elektronik dokumentacionin e mëposhtëm:

- CV (Curriculum Vitae)
- Letër motivimi

Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në humanresources@umt.edu.al

Pas selektimit do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.